



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1.3.2023

Nr: 77

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 10 SHKURT – 16 SHKURT 2023**

Sot, më datë 1.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kuvendi, Banka e Shqipërisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit-AKU, Bashkia Delvinë, Bashkia Fier, Bashkia Lushnjë, Bashkia Mallakastër, Bashkia Përmet, Bashkia Shkodër, Bashkia Kuçovë, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor.

OBJEKTI: Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të organeve publike për periudhën 10 shkurt deri më 16 shkurt 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92 dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Data: 1.3.2023 Nr: 77
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 10 shkurt - 16 shkurt 2023”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 10 shkurt deri më 16 shkurt 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 244 aktivitete. Nga verifikimi paraprak rezulton se 39 aktivitete të zhvilluara nga 16 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Në datë 17.2.2023, administrata e KQZ i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 22.2.2023, ora 11:00. Palët e interesuara depozituan pranë KQZ-së pretendimet e tyre si vijon;

1. **Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet *“Sesion informues mbi implementimin e Bonusit të rijetësimit”*, raportuar në datë 13.02.2023 për t'u zhvilluar në datë 17.02.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e tij, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nëpërmjet email-it të datës 21.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zj. Bilali më datë 13.2.2023 ka marrë njoftimin e ftesës nga Ministria e Kulturës për organizimin e sesionit informues mbi konservimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mbi implementimin e bonusit të rijetësimit. Kjo veprimtari u zhvillua më datë 17.2.2023, ora 15:00 në ambientet e Muzeu Marubi, Shkodër. Ky sesion u organizua me pjesëmarrjen e qytetarëve të Shkodrës dhe ku folës ishin Ministri i Kulturës zj. Elva Margariti, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes zj. Edona Bilali dhe Ministri i Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin zj. Erisa Spiropali. Fokusi kryesor i takimit ishte thirrja e të gjithë qytetarëve që zotërojnë apo merren me kujdesin e trashëgimisë kulturore dhe historike, që të bëhen pjesë e thirrjeve të Ministrisë së Kulturës për grante në kuadër të projektit “Bonusi i Rijetësimit”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

2. **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet *“Kujdesi dentar tek fëmijët në Kamëz”*, raportuar në datë 16.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 20.2.2023.
2. Aktivitet *“Kujdesi dentar tek fëmijët në Fushë Krujë”*, raportuar në datë 16.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 20.2.2023.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet email-it të datës 17.2.2023 ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar maksimalisht për raportimin në kohë dhe shterues të të gjitha aktiviteteve me karakter publik në përputhje me nenin 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Në lidhje me vonesën në raportimin e aktiviteteve të sjella në vëmendje, ju bëjmë me dije se ditën e Mërkurë, datë 15.02.2023, ka qenë e pamundur për të aksesuar ndërfaqen e KQZ nga ana jonë. Në këto kushte, në kuadër të detyrimit për të raportuar çdo aktivitet me karakter publik, aktivitetet e sipërpërmendura nuk janë raportuar në përputhje me afatet e përcaktuara”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka patur probleme me sistemin dhe hyrjen në llogari në ndërfaqe, për këtë arsye kanë raportuar aktivitetet e zhvilluara me vonesë.

Në këto kushte, duke mirëkuptuar rastet e problematikave që shkakton sistemi në ndërfaqe, tërheq vëmendjen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që në vijim, kur është i pamundur teknikisht aksesimi i ndërfaqes, të dërgojnë raportimin nëpërmjet email – it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor.

3. **Kuvendi i Shqipërisë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Fjala ime për Drejtësinë Sociale”*, raportuar në datë 16.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 20.2.2023.

Kuvendi, nëpërmjet email-it të datës 24.02.2023 ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se: *“Ne pergjigje te emailit tuaj, ju bej me dije se vonesa e raportimit te aktivitetit te dates 20 shkurt 2023 ka ardhur si pasojë e përlllogaritjes gabim të ditëve para datës së aktivitetit, data 16 shkurt është llogaritur si dita e parë dhe është përfshirë dhe data 20 shkurt (data e aktivitetit), si ditë për raportim aktiviteti.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se, Kuvendi ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit.

Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, tërheq vëmendjen Kuvendit në vijim të kryejnë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

4. **Banka e Shqipërisë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 12 (dymbëdhjetë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet *“Mbi pjesëmarrjen e Guvernatorit Sejko në Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të organizuar nga “Euromoney”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 11.1.2023.*
2. Aktivitet *“Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndërinstitucional në fushën e mbrojtjes së monedhave kundër falsifikimit”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 17.1.2023.*
3. Aktivitet *“Fjala e Guvernatorit Sejko në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e mbrojtjes së monedhave kundër falsifikimit”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 17.1.2023.*
4. Aktivitet *“Vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 18 janar 2023”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 18.1.2023.*
5. Aktivitet *“Në datën 30 janar 2023, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u prezantua Raporti i Tranzicionit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), 2022-2023”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023.*
6. Aktivitet *“Fjala e Guvernatorit Sejko në Prezantimin e Raportit të Tranzicionit të BERZH-it 2022 – 2023”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023.*
7. Aktivitet *“Më 1 shkurt 2023, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Politikës Monetare”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.2.2023.*
8. Aktivitet *“Banka e Shqipërisë organizon Konferencën e IV-t të Muzeut me temë: “Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.*
9. Aktivitet *“Organizohet Konferenca IV-t e Muzeut të Bankës së Shqipërisë “Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.*

10. Aktivitet *“Fjala përshëndetëse e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në Konferencën e IV-t të Muzeut të Bankës së Shqipërisë”*, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 8.2.2023.
11. Aktivitet *“Prezantimi i Raportit të Politikës Monetare, 2023/I, datë 9 shkurt 2023”*, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 9.2.2023.
12. Aktivitet *“Guvernatori Sejko merr pjesë në aktivitetin e organizuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë kushtuar “Të studiosh në Mbretërinë e Bashkuar”*, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 10.2.2023.

Banka e Shqipërisë nëpërmjet email-it të datës 20.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Banka e Shqipërisë nuk ka pasur njoftim zyrtar se kur duhej të fillonte raportimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në shkresën zyrtare drejtuar institucioneve të pavarura të datës 11 janar 2023 që keni publikuar në faqen tuaj të internetit, ju nuk e keni përfshirë Bankën e Shqipërisë dhe për rrjedhojë ne nuk kemi pasur informacion për datën zyrtare të fillimit të raportimit. Pasi kemi marrë emailin tuaj të datës 13 shkurt 2023, në faqen tuaj të internetit jemi njohur me faktin se data 13 janar 2023 është data e fillimit të raportimit dhe kemi raportuar gjithë eventet që nga ajo datë deri më sot”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstaton se administrata e KQZ -së nuk i ka dërguar Bankës së Shqipërisë njoftim me shkresë për procedurën që duhej të ndiqte për raportimin e veprimtarive publike.

Pavarësisht kësaj, sipas nenit 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor, Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Megjithatë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton situatën në të cilën është ndodhur Banka e Shqipërisë dhe vlerëson që në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

5. **Agjencia Shtetërore e Kadastrës** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet *“Raportim mbi Indikatorët e Performancës për ASHK 2006 – 2022”*, raportuar në datë 14.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 17.2.2023.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nëpërmjet email-it të datës 17.2.2023 ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Në lidhje me veprimtarinë “Raportim mbi Indikatorët e Performancës për ASHK 2006 – 2022”, të raportuar në datën 14.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 17.2.2023”, lejoni t’ju sqaroj se veprimtaria nuk është zhvilluar sot më datë 17.2.2023 sikurse*

është raportuar, dhe kjo datë është shënuar nga ana ime si rrjedhojë e një lapsusi, për të cilin shpresoj të kem mirëkuptimin tuaj. Ky takim me gazetarët në lidhje me veprimtarinë e Kadastrës për vitin 2022, do të zhvillohet ditët në vijim”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura dhe nga hetimi i kryer, vlerëson se aktiviteti i raportuar me vonesë nuk është zhvilluar dhe në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

6. **Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Reflektim i IoAFP-ve për procesin e vetëvlerësimit dhe diseminim e komunikim me grupet e interesit për nisjen e procesit të akreditimit”, raportuar në datë 13.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 16.2.2023.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional, nëpërmjet email-it të datës 20.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Mbas vështirësive të shumta për të gjetur në fillim accountin që duhet të përdornim për të ngarkuar në platformë aktivitetet, afati për raportim na kishte kaluar dhe vendosëm që këtë aktivitet mos ta zhvillojmë por e kemi lënë për një afat të dytë.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se, aktiviteti i raportuar me vonesë nuk është zhvilluar dhe në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

7. **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Aktiviteti me Zonjën e Parë Znj. Begaj do zhvillohet në ambientin e burgimit në IEVP Ali Demi. Pjesë e aktivitetit do jetë dhe mbjellja e luleve”, raportuar në datë 10.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 13.2.2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet email-it të datës 21.2.2023 ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve raportoi një veprimtari në datën 10.2.2023, një aktivitet me Zonjën e Parë zj. Armanda Begaj, e cila shprehu dëshirën e saj për të vizituar ambientet në Institucionin e Ekzekutimeve Penale “325 Ali Demi” me tematikë “Mbledhja e luleve”, duke i gëzuar sado pak të dënuarat në këtë IEVP, me shpresën se pas përfundimit të dënimit ka një rreze drite për to. Vlen të përmendim se datën për të zhvilluar aktivitetin me Zonjën e Parë e ka kërkuar Presidenca, e cila për shkak të*

ndryshimeve të agjendës në minutat e fundit, kërkuan zhvillimin e kësaj veprimtarie në datën 10.2.2023, e si pasojë Drejtoria jonë e pati të pamundur të raportonte brenda afateve të caktuara nga KQZ. Theksojmë se ky aktivitet nuk është publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve apo në ndonjë rrjet social dhe nuk ka pasur prezencë të medias.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, vlerëson se mbështetur në tematikën e aktivitetit që është zhvilluar dhe pjesëmarrjen e Zonjës së Parë zj. Begaj si ndër të ftuarit kryesorë në këtë aktivitet, mirëkupton pozitën e vështirë që është gjendur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në kushtet kur agjenda e Zonjës së Parë është mjaft e ngarkuar dhe e paparashikueshme, vlerëson që në këtë rast vullneti i institucionit nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit të veprimtarisë.

8. **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit - AKU** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
1. Aktivitet *“Ripublikim Takimi-Mbledhja e Komitetit Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë, ku Autoriteti Kombëtar i Ushqimit u përfaqësua nga Drejtoresha e Përgjithshme Znj. Jeta Deda”*, raportuar në datë 14.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 9.2.2023.
 2. Aktivitet *“Aplikimi i Sigurisë Ushqimore nga operatorë ushqimorë, përshtatja e konceptit ligjor në praktikën operacionale”*, ku u trajnuan në bashkëbisedime, praktikat që duhet të zbatohen për të garantuar sigurinë e të gjithë produkteve ushqimore, rregulloret, standardet që duhet të zbatohen, inspektimet nga autoritetet përgjegjëse, si dhe kapacitetet laboratorike për të kryer analiza”, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit-AKU, nëpërmjet email-it të datës 21.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se: *“Rezulton se AKU ka kryer me vonesë raportimet e mësipërme, për shkak të problemeve me kredencialet për të hyrë në sistem. Për këtë problematikë është komunikuar me KQZ dhe është dërguar edhe email, ku janë raportuar për veprimtarinë. Sapo është rregulluar sistemi, janë kryer raportimet në formën dhe kohën e duhur. Problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për këto shkelje që lidhen me këtë arsyetim. Gjithashtu, në aktivitetin “Ripublikimi Takimi-Mbledhja e Komitetit Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë, ku Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është përfaqësuar nga Drejtoresha e Përgjithshme Znj. Jeta Deda, raportuar në datën 14.02.2023 për t’u zhvilluar në datë 09.02.2023”, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, duke qenë në cilësinë e institucionit të ftuar ka qenë në pamundësi për të respektuar afatin ligjor të raportimit. ”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, vlerëson se lidhur me aktivitetin *“Ripublikim Takimi-Mbledhja e Komitetit Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë, ku Autoriteti Kombëtar i Ushqimit u përfaqësua nga Drejtoresha e Përgjithshme Znj. Jeta Deda”*, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit-AKU nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Lidhur me aktivitetin tjetër të raportuar me vonesë, mbështetur në rrethanat dhe faktet, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit-AKU ka patur probleme me sistemin, pajisjen me kredenciale dhe hyrjen në llogari, për këtë arsye kanë raportuar aktivitetet e zhvilluara me vonesë. Duke mirëkuptuar problematikat që janë shfaqur me sistemin dhe pajisjen me kredenciale të institucioneve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa vonesa ka ardhur për shkaqe të pavarura të institucionit.

9. **Bashkia Delvinë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Vizitë pranë fabrikës së letrës që kryen aktivitetin e saj në qytetin e Delvinës”*, raportuar në datë 13.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 17.2.2023.
- Aktivitet *“Pastrim në qytet nga punonjësit e administratës së Bashkisë Delvinë”*, raportuar në datë 14.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 18.2.2023.

Bashkia Delvinë, nëpërmjet email-eve të datës 17.2.2023 dhe 22.02.2023 ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Nga ana jonë është kryer përlllogaritja gabim (duke numëruar dhe të martën si ditë), nisur dhe nga fakti që aktivitetet nuk janë kryer, kërkojmë korrigjimin e datave duke plotësuar afatin ligjor”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se aktiviteti i raportuar me vonesë ka ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar të dispozitës ligjore të afatit 5 (pesë) ditor. Megjithatë, nga pretendimet e paraqitura dhe hetimi i kryer rezulton që Bashkia Delvinë nuk i ka zhvilluar aktivitetet e raportuara. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

10. **Bashkia Fier** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Vizitë në fabrikën e miellit Mokra, në mobilerinë XG, në thertoren Semanjaku, në një pikë grumbullimi drithërash”, raportuar në datë 16.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 20.2.2023.

Bashkia Fier, nëpërmjet email-it të datës 20.2.2023 dhe shkresës nr. 1048 prot., datë 22.02.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Është e vërtetë që raportimin e kemi kryer më datë 16 shkurt 2023 për aktivitetet e datën 20 shkurt 2023, por kjo nuk ka pasur si qëllim tejkalimin e afateve ligjore, thjesht ka qenë një përlogaritje e gabuar në kuadër të një lapsusi. Sapo u njohëm me këtë fakt, e riraportuam, pasi sistemi nuk të jep mundësinë e korrigjimit. Për të respektuar afatet ligjore të raportimit, aktivitetet e përcaktuara për të zhvilluar në datë 20 shkurt i shtymë dhe bëmë një raportim të ri në datën 18 shkurt. Aktualisht këto aktivitete janë programuar për t’u zhvilluar në datën 24 shkurt”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se aktiviteti i raportuar me vonesë ka ardhur si pasojë e përlogaritjes së gabuar të afatit për shkak të një lapsusi. Megjithatë, nisur nga pretendimet dhe hetimi i kryer rezulton që Bashkia Fier nuk e ka zhvilluar aktivitetin e raportuar me vonesë por ka shtyrë datën e zhvillimit të tij duke e riraportuar për në datë 24.02.2023.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

11. Bashkia Lushnjë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet *“Aktivitet kulturor festat e 7-8 Marsit”*, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.
2. Aktivitet *“Një takim ne formën e koktejlit me mësuesit e dalë në pension”*, raportuar në datë 15.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 7.2.2023.

Bashkia Lushnjë, nëpërmjet email-it të datës 17.2.2023 dhe datës 20.2.2023, ka dërguar pretendimet e saj, ku arsyeton se: *“Është një lapsus i paqëllimshëm në sistem, muaji mars është ngatërruar me muajin shkurt. Më poshtë po ju nis ripublikimet e rregulluara me datat përkatëse”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se, aktivitetet e raportuara me vonesë kanë ardhur si pasojë e një lapsusi të kryer nga Bashkia Lushnjë në hedhjen të dhënave. Megjithatë, nisur nga pretendimet dhe hetimi i kryer, rezulton që Bashkia Lushnjë nuk i ka zhvilluar aktivitetet e raportuara me vonesë por ka shtyrë datën e zhvillimit të tyre duke i ripublikuar në sistem.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

12. Bashkia Mallakastër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 6 (gjashtë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. *“Dëgjese publike për Rikonstruksionin e rrugës “Panahor-Ngraçan” (segmenti Panahor-Subashaj) dhe rruga “Ballsh-Drenovë e Re” (Segmenti Depo e Ujit-shkolla)”*, raportuar në datë 13.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 13.2.2023.
2. *“Dëgjese publike për Rikonstruksionin e rrugës “Rromës-Qafa e Drenovës”(segmenti Qendër-Rromës-Lagja -Tabakaj) rruga Fratar-Drizar dhe rruga “Ninësh-Nenaj-Damës”,* raportuar në datë 13.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 14.2.2023.
3. *“Inspektim te punimeve në zbatim”*, raportuar në datë 13.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 15.2.2023.
4. *“Inspektim të pritave lumore në lumin Vjosë”*, raportuar në datë 13.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 15.2.2023.
5. *“Takim me përfaqësues të biznesit privat “Fermer”, për ushtrimin e aktivitetit Luleshtrydhe”*, raportuar në datë 13.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 15.2.2023.
6. *“Vizite Agro Pyltari”*, raportuar në datë 13.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 15.2.2023.

Bashkia Mallakastër ka dërguar pretendimet e saj nëpërmjet email-it të datës 21.2.2023, ku arsyeton se: *“Sot më është bërë e mundur rikthimi i email tim zyrtar pasi kam pasur probleme teknike në lidhje me aktivizimin e tij. Më date 13.01.2023 jam pajisur me kredenciale nga ana juaj të cilat për arsyet e mësipërme nuk kam arritur t’i marr. Më datë 18.01.2023, punonjësi i IT i Bashkisë Mallakastër Z.Hasan Likaj i është drejtuar me email.aktivitete@kqz.gov.al për mundësinë e krijimit të një llogarie në lidhje me raportimin e veprimtarive publike. Më datë 07.02.2023, Z. Likaj ka nisur me email tek aktivitete@kqz.gov.al të gjitha datat e parashikuara me aktivitetet që do të zhvilloheshin gjatë muajit Shkurt nga Bashkia Mallakastër duke i sqaruar edhe mungesën e llogarisë. Në vijim më datë 13.02.2023 me komunikimet telefonike që kemi pasur me KQZ është bërë e mundur pajisja me kredenciale e punonjësit të IT Hasan Likaj. Që nga ky moment kemi filluar të bëjmë raportimet të cilat ju i keni konstatuar jashtë afatit 5 ditor, pra mungesa e raportimeve në kohë apo mosraportimi i disa prej tyre ka ardhur si pasojë e mospasjes së kredencialeve të dërguara nga ana juaj.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se vonesa e raportimit të veprimtarive publike ka ardhur si shkak i problematikave të pajisjes me kredenciale të Bashkisë Mallakastër. Gjatë hetimit administrativ dhe mbështetur në provat e dërguara nga institucioni rezulton se, Bashkia Mallakastër ka dërguar email në

aktivitete@kqz.gov.al, nëpërmjet të cilit provon se i ka dërguar KQZ-së kërkesën për t'u pajisur me kredenciale dhe raportimin e veprimtarive në kohë, pavarësisht se aktivitete@kqz.gov.al është një email që aktualisht nuk është funksional nga KQZ.

Për sa më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa vonesa ka ardhur për shkaqe të pavarura të institucionit.

13. Bashkia Përmet ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. *“Inspektim i punimeve në investimin “Ruga e Varrezave Përmet”*, raportuar në datë 10.2.2023 për t'u zhvilluar në datë 13.2.2023 .
2. *“Dhënie titulli qytetar nderi”*, raportuar në datë 16.2.2023 për t'u zhvilluar në datë 17.2.2023.

Bashkia Përmet, nëpërmjet emailit të datës 20.2.2023 ka dërguar pretendimet e saj ku arsyetohet se: *“Inspektimi i punimeve në investimin “Ruga e Varrezave Përmet” ka qenë i planifikuar për t'u kryer në fund të muajit shkurt (data e papërcaktuar), për shkak të ndryshimit të agjendave të pjesëmarrësve është bërë afrimi i tij në datë 13.02.2023. Ky aktivitet i raportuar nuk është kryer. Aktiviteti “Dhënie titulli qytetar nderi” organizohej nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër, me tematikë dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Qarkut Gjirokastër” z. Vasil Çuri. Për agjendën, vendin ku do të zhvillohej aktiviteti, data dhe ora, Bashkia Përmet është njoftuar dy ditë para, gjë e cila ka çuar në raportimin me vonesë të tij”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura si dhe nga hetimi i kryer vlerëson se, aktiviteti *“Inspektim i punimeve në investimin “Ruga e Varrezave Përmet”*, nuk është zhvilluar dhe në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, për aktivitetin *“Dhënie titull qytetar nderi”* Bashkia Përmet nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

14. Bashkia Shkodër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. *"Festa e Pavarësisë së Kosovës"*, raportuar në datë 16.2.2023 për t'u zhvilluar në datën 17.2.2023.
2. *"Pjesëmarrje në aktivitetin Ditët e Kujtesës"*, raportuar në datë 16.2.2023 për t'u zhvilluar në datë 18.2.2023.
3. *"Pjesëmarrje në aktivitet"*, raportuar në datë 16.2.2023 për t'u zhvilluar në datë 20.2.2023.

Bashkia Shkodër, nëpërmjet emailit të datës 21.2.2023, ka dërguar pretendimet e saj ku arsyeton se: *"Këto aktivitete nuk janë organizuar nga Bashkia Shkodër. Sikurse është përcaktuar edhe në pjesën përshkrimore të publikimit online, secili aktivitet ka për organizator një palë të 3-të, që sipas rastit është Komuna e Gjakovës për aktivitetin "Festa e Pavarësisë së Kosovës" apo Konrad Adenauer Stiftung për aktivitetin "Ditët e Kujtesës" apo aktiviteti 3. Ftesë për pjesëmarrje, i cili është organizuar nga Universiteti "Luigj Gurakuqi". Pra roli i Bashkisë Shkodër ka qenë pjesëmarrjes dhe jo organizator i këtyre aktiviteteve, sikurse referohet në pikën 2 dhe 3 të shkresës nr. prot 137, datë 11.01.2023"*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se Bashkia Shkodër nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këto aktivitete, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

15. **Bashkia Kuçovë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- *"Aktivitet për 11 Shkurtin, greva e punëtorëve"*, raportuar në datë 10.2.2023 për t'u zhvilluar në datë 11.2.2023.

Bashkia Kuçovë, nëpërmjet emailit të datës 20.2.2023, ka dërguar pretendimet e saj ku arsyeton se: *"Institucioni jonë ka pasur probleme për të raportuar në ndërfaqen e raportimit të aktiviteteve. Kemi tentuar disa herë për të raportuar këtë aktivitet, por ka qenë e pamundur teknikisht. Ky aktivitet nuk ishte një organizim i Bashkisë Kuçovë. Ishte një organizim i Shoqatës së Veteranëve dhe Kryetari i Bashkisë ishte vetëm një nga pjesëmarrësit në këtë aktivitet. Aktiviteti është raportuar me vonesë për probleme teknike që nuk varen nga ne dhe nuk ishin aktivitet tona. Nuk ka asnjë provë që kryetari i Bashkisë ka ndikuar ose urdhëruar raportimin me vonesë"*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se, sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk ndodhet përpara kundërvajtjes administrative.

16. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- *“Konkurs Ndërkombëtar për “Muzeun Besa”, raportuar në datë 11.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 15.2.2023.*

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor, nëpërmjet emailit të datës 20.2.2023, ka dërguar pretendimet e tij ku arsyeton se: *“Raportimi mbi aktivitetin e mbajtur në datë 15.02.2023 pranë TKOBAP u nis si proces nga ana e TKOBAP-së në datën 10.02.2023 fillimisht në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike në KQZ sipas afateve të parashikuara në vendim. Por, për shkak të problemeve në aksesin e saj, nuk u përfundua brenda afateve të përcaktuara pasi nuk mund të logoheshim në të. Në datën 11.02.2023 u pajisëm me passwordin e ri të ndërfaqes e si rrjedhojë raportimi mbi aktivitetin e lartpërmendur u realizua në këtë datë”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se vonesa e raportimit të veprimtarisë publike ka ardhur si shkak i problematikave të hyrjes në sistem. Gjatë hetimit administrativ rezulton se, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor për shkak të pamundësisë për të aksesuar në ndërfaqe ka dërguar email KQZ-së në aktivitete@kqz.gov.al, por për shkak se ky email nuk është funksional, nuk kanë mundur të hyjnë në sistem dhe të raportojnë aktivitetin në kohë. Megjithatë, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor ka provuar se pavarësisht problemit me ndërfaqen, kanë raportuar aktivitetin nëpërmjet email – it, pavarësisht se nuk është funksional nga KQZ. Për sa më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa vonesa ka ardhur për shkaqe të pavarura të institucionit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik,

e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:

- a) Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,
- b) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
- c) Kuvendi,
- ç) Banka e Shqipërisë,
- d) Agjencia Shtetërore e Kadastrës,
- dh) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional,
- e) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,
- ë) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit,
- f) Bashkia Delvinë,
- g) Bashkia Fier,
- gj) Bashkia Lushnjë,
- h) Bashkia Mallakastër
- i) Bashkia Përmet,
- j) Bashkia Shkodër,
- k) Bashkia Kuçovë,
- l) Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor

2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI